

IADSA II

Marrëveshja Italo-Shqiptare e Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (Faza e Dytë)

THIRRJE PËR PROPOZIME NR. REF. IADSA II/2019/01

THIRRJE PËR PROPOZIME

Kjo Thirrje për Propozime është Thirrja e Parë në kuadrin e Fazës së Dytë të Marrëveshjes Italo-Shqiptare të Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA II), një iniciativë e Programit Aktual Italo-Shqiptar të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit për të mbështetur zhvillimin social në Shqipëri duke ofruar burime financiare për realizimin e projekteve të propozuara nga institucionet e pranueshme publike shqiptare. Projektet e pranueshme duhet të jenë:

- të bazuara në prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të përfshira në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe me strategji të përditësuara sektoriale dhe ndër-sektoriale si edhe me Planin Kombëtar të Veprimit për Realizimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit të Republikës së Shqipërisë (MSA);
- në përputhje me fushat prioritare të identifikuara nga Programi Italo-Shqiptar i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit, dhe
- të lidhura me objektivat dhe fushat e ndërhyrjes në vijim: zhvillimin e burimeve njerëzore, punësimin, promovimin e barazisë gjinore, rritjen e përfshirjes sociale, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve të papunë, grave në nevojë, pakicave, njerëzve me aftësi të kufizuara, territoreve me pak shërbime; të mbështetet mbrojtja sociale e grupeve të cënueshme, në kontekstin e një pjesëmarrjeje të vërtetë në komunitet, si dhe përdorimin ekologjikisht të qëndrueshëm të burimeve, dhe zhvillimin e qëndrueshëm territorial për krijimin e vendeve të punës dhe trajtimin e modeleve të pabarabarta të zhvillimit ekonomik.

Tabela e Lëndës

1.	INFORMACION HISTORIK	3
2.	PROGRAMI IADSA II.....	4
2.1.	Shpjegim i IADSA	5
2.2.	Objektivat specifike të kësaj Thirrje të Parë për Propozime	5
2.3.	Strategjia.....	6
3.	RREGULLAT E KËSAJ THIRRJE PËR PROPOZIME.....	8
3.1.	Kriteret e pranueshmërisë.....	8
3.1.1.	Pranueshmëria e Aplikantëve: kush mund të aplikojë.....	8
3.1.2.	Partneritetet dhe pranueshmëria e partnerëve.....	8
3.1.3.	Projektet e Pranueshme	10
3.1.4.	Pranueshmëria e kostove: kostot që mund të merren në konsideratë për grantin	11
3.2.	Si të aplikohet dhe procedurat që duhen ndjekur	14
3.2.1.	Formulari i Aplikimit për Grant, Buxheti dhe Plani i Veprimit	14
3.2.2.	Si dhe ku do të dërgohen propozimet.....	14
3.2.3.	Afati për pranimin e Propozimeve	16
3.2.4.	Informacion i mëtejshëm.....	16
3.3.	Vlerësimi dhe përzgjedhja e Propozimeve	16
3.3.1.	HAPI 1: Kontrolli administrativ.....	16
3.3.2.	HAPI 2: Verifikimi i pranueshmërisë	117
3.3.3.	HAPI 3: Vlerësimi i Propozimit.....	117
	TABELA VLERËSUESE	19
3.4	Njoftimi i vendimit të Komitetit të Menaxhimit të IADSA	21
3.4.1.	Përmbajtja e vendimit	21
4.	LISTA E SHTOJCAVE	22
	SHTOJCA A: FORMULARI I APLIKIMIT PËR GRANT (WORD)	22
	SHTOJCA B: FORMULARI I ENTITETEVE LIGJORE (FORMATI WORD)	22
	SHTOJCA C: DEKLARATA E PARTNERITETI.....	22
	SHTOJCA D: BUXHETI (FORMATI EXCEL)	22
	SHTOJCA E: PLANI I VEPRIMIT (FORMATI EXCEL).....	22
	SHTOJCA F: MARRËVESHJA E PARTNERITETIT	22
	SHTOJCA G: DOKUMENTET MBËSHTETËSE PËR APLIKANTIN	22
	SHTOJCA H: DOKUMENTET MBËSHTETËSE PËR PARTNERËT	22
	SHTOJCA I: KONTRATA E PROJEKTIMIT DHE FINANCIMIT	22
	SHTOJCA L: UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT.....	22

1. INFORMACION HISTORIK

Shqipëria dhe Italia janë lidhur fort përmes një marrëdhënieje historike dhe jo vetëm për arsye gjeografike.

Bashkëpunimi Italian për Zhvillim i fillon veprimtaritë e tij në vitin 1991 dhe në dy dekadat e fundit, Italia ka qenë deri më sot një prej donatorëve kryesorë dypalësh aktiv në vend, partneri më i madh tregtar dhe destinacioni i parë i emigracionit Shqiptar.

Në vite, Bashkëpunimi Italian e ka ndihmuar Shqipërinë në tranzicionin e saj drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Ndihma Italiane Zyrtare për Zhvillim (ODA) ka disbursuar në Shqipëri shuma rreth 700 milionë Euro me qëllim përballjen e emergjencave të viteve 1990, mbështetjen e modernizimit të infrastrukturave publike, nxitjen e rritjes së qëndrueshme socio-ekonomike, promovimin e demokratizimit dhe fuqizimit institucional dhe në vitet e fundit, shoqërimin e integritit të vendit në BE.

Në ditët e sotme, strategjia dhe objektivat e Bashkëpunimit Italian për Zhvillim (IDC) janë përshtatur në strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim të Qeverisë së Shqipërisë e cila është në qendër të procesit të pozicionimit dhe harmonizimit të partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë. Fushat e ndërhyrjes janë pranuar në nivel bilateral mbi një bazë shumëvjeçare dhe përqendrohen kryesisht në rritjen e qëndrueshme me fokus të veçantë në konkurrencën dhe inovacionin e përmirësuar përfshirë zhvillimin bujqësor e rural, zhvillimin e sektorit privat në të cilin Italia luan rolin kryesor ndër donatorët Evropianë dhe zhvillimin social, duke u përqendruar në zhvillimin e burimeve njerëzore, përfshirjen sociale dhe kohezionin e territorit.

Strategjia dhe Objektivat e IDC-së promovojnë një qasje pjesëmarrëse, me vëmendje të veçantë në barazinë gjinore dhe mbrojtjen mjedisore dhe me pjesëmarrje aktive të Rajoneve Italiane dhe autoriteteve vendore në Itali, nëpërmjet bashkëpunimit të decentralizuar dhe pjesëmarrjes së plotë të shoqërisë civile italiane e shqiptare nëpërmjet OJF-ve.

Lidhja e fortë e tërë “Sistema Italia” me partnerët shqiptarë, ka bërë që Italia të jetë në rolin zyrtar të një *donatori lehtësues* në kuadrin e iniciativës Evropiane “*Iniciativa Përshpejtuese mbi Ndarjen e Punës – Fast Track Initiative on Division of Labour*” (FTI-DoL), e cila ka përfshirë parimet e pranuar nga Deklarata e Parisit, Axhenda për Veprim e Accra-s) mbi Efikasitetin e Ndihmës dhe Partneritetin e Busanit për Bashkëpunimin e Zhvillimit Efektiv.

Një mundësi tjetër për partneritete përfshirëse të “Sistemi Itali” në Shqipëri ofrohet nga Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA). Strategjia e përgjithshme pas Marrëveshjes Italo - Shqiptare për Konvertimin e Borxhit për Zhvillim (IADSA), ndjek parimet themelore të pranuar në nivel dypalësh ndërmjet Palëve në kuadrin e Protokollit të Bashkëpunimit për Zhvillim për periudhën 2014-2016, që pasqyrojnë Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës si dhe Kodin Evropian të Etikës.

Në pajtim me Marrëveshjen “Konvertimi i Borxhit për Zhvillim” midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, Ministria e Financës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar

të Italisë (MAECI) - kanë krijuar një “Fond Homolog” (FH) dhe Komitetin përkatës të Menaxhimit (më poshtë referuar si Komiteti i Menaxhimit i IADSA-s) me Njësinë e tij të Mbështetjes Teknike (më poshtë referuar si NjMT).

2. PROGRAMI IADSA II

Programi IADSA II përfaqëson një instrument novator financimi për Shqipërinë dhe ka si qëllim të mbështesë iniciativat e zhvillimit social të promovuara nga institucionet publike Shqiptare me një kontribut financiar total prej 20 Milionë Euro në pesë vjet (2019-2024). IADSA II iu përgjigjet parimeve më të përparuara të efektivitetit të zhvillimit duke promovuar kohezionin social në baza territori dhe duke mbështetur zhvillimin e balancuar rajonal, barazinë sociale dhe krijimin e vendeve të punës për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky mekanizëm financimi lejon përdorimin e burimeve financiare të destinuara përndryshe për t’i paguar Italisë borxhet e kontraktuara më parë për zhvillimin e infrastrukturës në vend. Fondet e IADSA II do të përdoren për financimin e nismave të zhvillimit social të promovuara nga institucionet publike Shqiptare, me qëllim përmirësimin e kohezionit social në baza territori, zhvillimin e balancuar rajonal, barazinë sociale dhe krijimin e vendeve të punës për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian

Në këtë kuadër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ambasada Italiane në Tiranë kanë krijuar Komitetin e Menaxhimit të IADSA-s, të përbërë nga Ambasadori Italian dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë. Komiteti i Menaxhimit i IADSA-s mbështetet nga një Njësi Mbështetjeje Teknike (NjMT) dhe ndihmohet nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Tiranë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti për Zhvillimin, Programet, Financimin dhe Ndihmën e Huaj në Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Projektet përzgjidhen nëpërmjet Thirrjeve për Propozime të nisura periodikisht, në të cilat kanë të drejtë të aplikojnë të gjitha Institucionet Publike Shqiptare. Bashkëpunimet apo partneritetet me OJF-të Shqiptare dhe/ose Italiane, dhe/ose Rajone Italiane dhe Autoritete Vendore dhe/ose Organizata Ndërkombëtare (ON) janë të lejuara për zbatimin e pjesëshëm apo të plotë të projekteve.

Projektet e pranueshme duhet të bazohen mbi prioritetet strategjike të Qeverisë Shqiptare të përfshira në strategjitë kombëtare, strategjitë e përditësuara sektoriale dhe ndër-sektoriale dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit (MSA) dhe në lidhje me fushat prioritare në vijim: zhvillimin e burimeve njerëzore, punësimin, promovimin e barazisë gjinore, rritjen e përfshirjes sociale, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve të papunë, grave në nevojë, pakicave, njerëzve me aftësi të kufizuara dhe të mbështetet mbrojtja sociale e grupeve të cënueshme, në kontekstin e një pjesëmarrjeje të vërtetë në komunitet, si dhe përdorimin ekologjikisht të qëndrueshëm të burimeve.

2.1. Shpjegim i IADSA II

Që nga vendosja e demokracisë, Shqipëria u është nënshtruar ndryshimeve të mëdha sociale e ekonomike duke arritur statusin e një vendi me të ardhura mbi mesataren si rezultat i reformave të ndërmarra, të cilat duhet të fuqizohen në përputhje me sfidat e reja të krijuara nga niveli aktual i zhvillimit. Në fakt, Shqipëria ka një potencial të madh zhvillimi, duke i mbështetur përparësitë e saj konkurruese në pozitën e saj gjeografike, burimet njerëzore dhe pasuritë materiale.

Shoqërisë shqiptare i nevojitet përmirësim thelbësor në zhvillimin social duke integruar edhe grupet marginale dhe të cenueshme të cilat kryesisht përfshijnë familje me të ardhura të ulëta dhe familje të tjera të marginalizuara (për shembull rinia dhe të papunët në zonat rurale, familje që u përkasin grupeve etnike të minoritetit, njerëzit me aftësi të kufizuara, etj.). Ofrimi i shërbimeve sociale me cilësi të mirë është një aspekt i rëndësishëm i standardeve të jetesës dhe siguron kohezionin social. Në të njëjtën kohë, politikatat sociale duhet të orientohen drejt respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit. Prandaj, politika të integruara dhe koherente synojnë të arrijnë zhvillim të balancuar rajonal për të reduktuar pabarazitë midis rajoneve. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të administratës publike për të dhënë shërbime sociale dhe angazhimi i saj për zbatimin e strategjive kombëtare për zhvillim dhe integrim është çelësi për të përballuar me sukses sfidën e integritit evropian.

Shpjegimi i IADSA II është të vërë në dispozicion burime financiare shtesë për të përmirësuar shërbimet sociale si edhe për të mbështetur përfshirjen sociale të personave të rrezikuar nga varfëria dhe përjashtimi, dhe për të përforcuar barazinë shoqërore dhe ulur pabarazitë rajonale së bashku me asistencën që synon të mbështesë proceset e reformës, zhvillimin e kapitalit njerëzor, zgjerimin e një shoqërie të bazuar në njohuri të avancuara, planifikimin me pjesëmarrje dhe promovimin e besimit social dhe solidaritetit, si dhe konsensusit për grupin e përbashkët të objektivave.

2.2. Objektivat specifike të kësaj Thirrje të Parë për Propozime

Objektivat specifike të kësaj Thirrje të Parë për Propozime mund të përmbliidhen shkurtimisht si më poshtë ⁽¹⁾:

- a. Të kontribuojë për zhvillimin e arsimit cilësor, novator dhe gjithëpërfshirës për të siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet pas dhe të reduktojë hendeqet gjinore, nëpërmjet rinovimit & pajisjes së ndërtesave publike ekzistuese dhe/ose infrastrukturës së specializuar;
- b. Të trajtojë pabarazitë në ofrimin e shërbimit në sistemin publik të kujdesit shëndetësor,

¹ Objektivat pasuese të identifikuara për këtë Thirrje të Parë për Propozime janë ato të cilave duhet t'u referohen Aplikantët në Përgatitjen e Projekt Propozimeve të tyre.

përfshirë kujdesin shëndetësor parandalues, duke përforcuar aksesin në shërbime bazë me cilësi të mirë, novatore dhe efikase për të përmirësuar shëndetin e popullatës, nëpërmjet rinovimit & pajisjes së ndërtesave publike ekzistuese dhe/ose infrastrukturës së specializuar;

- c. Të përmirësojë shërbimet e kujdesit shoqëror për personat në nevojë (për shembull, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit në vështirësi, jetimët) në familjet dhe komunitetet e tyre për të integruar shërbimet rezidenciale në shërbime të lëvizshme dhe të bazuara në komunitet në mënyrë graduale;
- d. Të mbështesë përfshirjen sociale të atyre që rrezikojnë varfërinë dhe përjashtimin (p.sh. personat me aftësi të kufizuara, pakicat, fëmijët në nevojë, të papunët afatgjatë dhe të rinjtë e papunë, gratë e disavantazhuara, migrantët e rikthyer në atdhe) duke rritur aksesin e tyre në arsim formal dhe mësimdhënie jo formale dhe informale, programe punësimi, kulture dhe TIK-u;
- e. Të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm lokal në mënyrë që të tejkalohet mungesa e mundësive të punësimit dhe të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore, të promovojë ekonominë qarkulluese, ndërmarrjet sociale, dhe investimet me ndikim social me vëmendje të veçantë ndaj territorit në zonat rurale pa shërbime.

Barazia gjinore dhe qëndrueshmëria ekologjike do të konsiderohen si çështje shumë të rëndësishme ndërsektoriale gjatë vlerësimit të projekt propozimeve.

2.3. Strategjia

Strategjia e përgjithshme e Programit IADSA II ndjek parimet bazë të miratuara në nivel dypalësh midis palëve në kuadrin e Programit Italo - Shqiptar për Bashkëpunim dhe Zhvillim, që pasqyron Deklaratën e Parisit mbi Efikasitetin e Ndihmës si dhe Kodin Evropian të Sjelljes.

Duke ndjekur parimet thelbësore të efikasitetit të partneritetit për zhvillim, Programi IADSA II mirëpret partneritete dhe bashkëpunime duke synuar maksimizimin e ndikimit të inputit të çdo partneri. Përpjekjet për të përfshirë partneritete të reja të cilat promovojnë inovacion dhe përgjegjshmëri të ndërsjellë, e kanë vërtetuar efikasitetin e tyre përmes rezultateve të arritura dhe elementëve mbështetës përmes programeve dhe veprimeve të tjera.

Mbi bazën e kritereve të OECD – Komiteti i Asistencës për Zhvillim, vlerësimi i Projekt Propozimeve do të kryhet në përputhje me parimet thelbësore që vijnë.

Përshtatshmëria

Në përputhje me kriteret e *përshtatshmërisë*, do të vlerësohet se si do të kontribuojë rezultati i pritshëm i Projekt propozimit në arritjen e objektivave të Programit të IADSA, Strategjive dhe Politikave Kombëtare dhe Vendore të Republikës së Shqipërisë dhe grupeve të synuara dhe përfituesve përfundimtare.

Efikasiteti

Në përputhje me kriteret e **efikasitetit** do të vlerësohet se në çfarë mase: i) aktivitetet e përfshira në Projekt propozim janë të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme dhe ii) rezultatet e identifikuar janë të matshme nëpërmjet treguesve objektivisht të verifikueshëm.

Qëndrueshmëria & Ndikimi në komunitet

Qëndrueshmëria ka të bëjë me vlerësimin nëse përfitimet e një aktiviteti kanë predispozitën të vazhdojnë pasi të jetë tërhequr financimi i jashtëm. Rezultatet e Projektit nevojitet të jenë të qëndrueshme nga ana institucionale, mjedisore, sociale si edhe financiare. Kriteri i *Ndikimit* do të vlerësojë se si rezultatet e pritshme të Projekt-propozimit do të sjellin efekte të prekshme pozitive në nivel komuniteti.

3. RREGULLAT E KËSAJ THIRRJE PËR PROPOZIME

3.1. Kriteret e pranueshmërisë

3.1.1. Pranueshmëria e Aplikantëve: kush mund të aplikojë

- Bashkitë në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen territoriale dhe administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, janë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e Projektit me partnerët e tyre (nëse ka), duke mos vepruar si ndërmjetës.

3.1.2. Partneritetet dhe pranueshmëria e partnerëve

Kandidatët mund të veprojnë individualisht ose si konsorcium me çdo Institucion tjetër Publik Shqiptar dhe/ose organizata partnere që duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme të pranueshmërisë:

- të jenë persona juridikë

dhe

- të jenë jofitimprurës

dhe

- të jenë një organizatë Shqiptare jo fitimprurëse (OJF) siç përcaktohet në Ligjin shqiptar Nr. 8788, datë 07.05.2011

ose

- të jenë organizatë jo fitimprurëse Italiane e shoqërisë civile ose OJF aktive në Shqipëri, qoftë me zyra të tyre ose nëpërmjet një projekti në proces, në ditën e çeljes së kësaj Thirrje për Propozime

ose

- të jenë Rajone Italiane ose Autoritet Vendor, sipas përcaktimeve të Nenit 2 të Dekretit Legjislativ Italian Nr. 267, datë 18.08.2000, dhe akteve në vijim (pra “Akti i Konsolidimit të Autoriteteve Vendore”) ⁽²⁾

² Autoritetet Vendore Italiane janë bashkitë, provincat, qytetet metropolitane, komunitetet malore, komunitetet ishullore, dhe unionet e bashkive të riorganizuar sipas Ligjit italian Nr. 56, datë 07.04.2014

ose

- të jenë organizata ndërkombëtare (ndërqeveritare) siç përcaktohet nga Neni 43 i Rregullave Zbatuese të Rregullores Financiare të BE-së ⁽³⁾.

Partnerët e Aplikantëve marrin pjesë në hartimin dhe implementimin e Projektit dhe kostot që ata përballojnë gjatë zbatimit të projektit, janë të pranueshme në të njëjtën mënyrë si ato të përballuara nga Aplikanti.

Programi IADSA II do të pranojë nënkontraktues të ndryshëm nga institucionet publike partnere dhe/ose organizata të specifikuar në Propozime, të cilët iu nënshtrohen rregullave të prokurimit të ekspozuara në Shtojcën L.

Aplikanti do të veprojë si organizatë udhëheqëse dhe, në qoftë se përzgjidhet, si “Njësi Ekzekutive” edhe në qoftë se partneri/ët është/janë Institucion/e të tjera Publik/e Shqiptare. Në një rast të tillë, Aplikanti do të jetë pala e vetme kontraktuese përgjegjëse ndaj Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s.

Aplikantët e mundshëm dhe partnerët e tyre mund të mos marrin pjesë në Thirrjet për Propozime të IADSA II ose t’u akordohen grante në qoftë se janë në njërin nga situatat e renditura në Seksionin 2.3.3 të Udhëzuesit Praktik të BE-së për procedurat e kontraktimit (të disponueshme nga adresa e mëposhtme në Internet):

<http://ec.europa.eu/europeaid/prag/document.do?nodeNumber=2.3.3.1>

Në Shtojcën C “Deklarimi i Partneritetit” të Formularit të Aplikimit për Grant, partnerët duhet të deklarojnë se ata nuk gjenden në ndonjërin prej këtyre situatave.

³ Organizata ndërkombëtare janë organizatat ndërkombëtare të sektorit publik, të krijuara nga marrëveshje ndërqeveritare si edhe agjencitë e specializuara të krijuara prej tyre; Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) dhe Federata Ndërkombëtare e Shoqërive Kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe, Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe Fondi Evropian i Investimeve (EIF) njihen gjithashtu si organizata ndërkombëtare.

3.1.3. Projektet e Pranueshme

Objektivat

Të gjithë Projektet duhet të synojnë në arritjen e **të paktën njërit** prej objektivave specifike të identifikuar për këtë Thirrje të Parë për Propozime dhe të renditura në Paragrafin 2.2 më lart.

Vendndodhja

Projekti duhet të zhvillohet në **Shqipëri**. Veprimtaritë e veçanta mund të zbatohen në vendet fqinje me Shqipërinë, nëse kostot e tyre janë tërësisht të mbuluara nga burime të tjera financimi (4).

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e një Projekti **nuk mund të kalojë 24 muaj**.

Projekte të papranueshme

Llojet e mëposhtme të projekteve janë të papranueshme:

- Projekte që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizime për pjesëmarrje në simpoziume, seminare, konferenca, kongrese;
- Projekte që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me bursa për studime ose kurse trajnimi;
- Konferencat si dhe aktivitetet e hulumtimit mund të financohen vetëm në qoftë se 1) ato justifikohen siç duhet dhe bëjnë pjesë në objektivat e Projektit; dhe 2) ato formojnë pjesë të një game më të gjerë aktivitetesh për tu zbatuar gjatë kohës së Projektit, të hartuara për të arritur rezultate konkrete dhe të prekshme;
- Asistenca Teknike dhe/ose Trajnimet mund të financohen vetëm në qoftë se justifikohen siç duhet dhe janë koherente me objektivat specifike të Projekteve dhe janë themelore për të arritur rezultate të prekshme;
- Projektet që konsistojnë tërësisht ose në pjesën më të madhe në punë përgatitore apo studime;
- Projekte që mbështesin parti politike;
- Financim thelbësor i Aplikantëve ose (nëse ka) partnerëve të tyre;
- Financime të deficitit dhe kapitaleve;
- Subvencione për organizata private (përfshirë edhe ato jo fitimprurëse);
- Blerje e tokës, ndërtesës dhe zyrave;
- Financim prapaveprues për projekte që janë tashmë duke u zbatuar ose të përfunduar;
- Projekte që zhvillohen jashtë Shqipërisë.

⁴ Këto burime të tjera financimi duhet të jenë të përshkruara qartë në Formularin e Aplikimit par Grant (Shtojca A) dhe të identifikuar si bashkëfinancim në Formularin e Buxhetit (Shtojca D). Kostot për këto aktivitete nuk janë të pranueshme për Grantin e IADSA.

Numri i aplikimeve dhe grantet për çdo Aplikant dhe Partnerin(ët) e tij

- Një aplikant nuk mund të paraqesë më shumë se 1 (një) aplikim për këtë Thirrje për Propozime;
- Çdo Partner tjetër mund të marrë pjesë në maksimumi 1 (një) aplikim nën këtë Thirrje për Propozime.

Dorëzimet e aplikimeve në numër më të madh nga sa përcaktohet më lart do të shkaktojnë refuzimin e të gjitha aplikimeve të dorëzuara nga i njëjti Aplikant dhe/ose të njëjtët Partnerë.

3.1.4. Pranueshmëria e kostove: kostot që mund të merren në konsideratë për grantin

Sipas kësaj Thirrje për Propozime, çdo grant i akorduar nga Komiteti i Menaxhimit i IADSA-s do të jetë në shumën nga 200,000 deri 400,000 Euro ose shumë ekuivalente ⁽⁵⁾.

Aplikantët duhet të pasqyrojnë të gjithë buxhetin në LEK Shqiptar duke detajuar të gjithë kostot, përfshirë ato të financuara nga burimet e vetë Aplikantit ose të partnerëve të tij (për shembull pagat, pagesat për sigurimet shoqërore, qiranë ose çdo kosto tjetër të përsëritur ose kapitale) dhe duke specifikuar burimet e financimit.

Gjithashtu, si garanci e motiveve të Aplikantëve dhe elementëve mbështetës të Projektit dhe në mënyrë që të promovohet krijimi/forcimi i partneritetit me anë të mekanizmave bashkëfinancues, Komiteti i Menaxhimit i IADSA-s i inkurajon Aplikantët për ndarjen e kostove dhe kontribut të drejtpërdrejtë të natyrës financiare ose në natyrë, që konsiston në inpute për projektin dhe/ose aktivitetet. Ndarja e kostove dhe/ose kontributi i drejtpërdrejtë do të merren në konsideratë në tabelën e vlerësimit.

Vetëm kostot e pranueshme mund të merren parasysh për një grant. Ato janë renditur më poshtë. **Mbani parasysh që kostot e pranueshme duhet të bazohen në kosto reale, jo thjesht një shumë** (me përjashtim të kostove të jetesës si dietat).

Në procesin e verifikimit të kostove, NjMT e Komitetit i Menaxhimit i IADSA II mund të kërkojnë sqarime ose ndryshime buxheti.

Prandaj, është në interesin e aplikantit që të paraqesë **një buxhet realist dhe me kosto efektive** të shoqëruar me të gjithë argumentet për të lehtësuar procesin e verifikimit.

⁵ Ekuivalenti në LEK shqiptar me kursin e shkëmbimit të dhënë nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e publikimit të kësaj Thirrje për Propozime (20 shtator 2016).

Kostot direkte të pranueshme

Që të jenë të pranueshme sipas kësaj Thirrje për Propozime, kostot duhet të:

- jenë të domosdoshme për realizimin e Projektit të propozuar dhe të pajtohen me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, në veçanti vlera për paratë dhe efikasiteti i kostos;
- të jenë shpenzuar realisht nga Aplikantët ose partnerët e tyre gjatë periudhës së zbatimit të Projektit. Të gjithë shpenzimet duhet të likuidohen para se të finalizohet raporti përfundimtar;
- të jenë regjistruar në llogaritë ose dokumentet tatimore të aplikantit ose të partnerëve të aplikantit, të jenë të identifikueshme dhe verifikueshme dhe të mbështeten nga origjinalet e dokumenteve mbështetëse.

Duke iu nënshtruar procedurave të zbatimit (Shtojca L) që zbatohen, kostot e drejtpërdrejta të pranueshme të bëra nga aplikanti dhe partnerët e tij mund të përfshijnë:

- kostot e personelit të caktuar për Projektin, që i korrespondojnë pagave reale plus pagesat për sigurimet shoqërore dhe kostot e tjera lidhur me shpërblimet. Pagat dhe kostot nuk duhet të tejkalojnë ato të përballuara normalisht nga institucionet publike shqiptare dhe/ose organizatat partnere, siç mund të jetë rasti, veçse kur kjo justifikohet duke treguar se është thelbësore për të realizuar Projektin;
- kostot për stafin, konsultimet, trajnimet dhe veprimtari të tjera të përcaktuara në Projekt nëse vlera e tyre është maksimumi 25% e kostove të drejtpërdrejta të pranueshme të Projektit të financuara nga IADSA II, kostot e blerjes apo të marrjes me qira për pajisje dhe furnizime (të reja ose të përdorura) posaçërisht për qëllimet e Projektit dhe kostot e shërbimeve me kusht që ato t'u korrespondojnë normave të tregut;
- kostoja e materialeve të konsumit;
- kostot që lindin drejtpërdrejt nga kërkesat e kontratës (shpërndarja e informacionit specifik për projektin, përkthimi, printimi, sigurimi, etj.) duke përfshirë kostot bankare;
- taksat, duke përfshirë TVSH-në, të detyrueshme për Aplikantin (ose partnerët e aplikantit), vetëm në lidhje me aktivitetet e projektit.

Kontributet në natyrë

Çdo kontribut në natyrë i dhënë nga Aplikanti apo çdo burim tjetër, që duhet të renditet në Formularin e Aplikimit për Grant (Shtojca A Seksioni I paragrafi 3), nuk përfaqëson shpenzim

real dhe nuk është kosto e pranueshme. Ato nuk do të trajtohen si bashkëfinansim nga Aplikanti ose partneri i tij në qoftë se janë kosto të funksionimit të përditshëm të strukturave përkatëse.

Kontributi i drejtpërdrejtë financiar ose në natyrë që konsiston në inpute për projektin dhe/ose aktivitete, duke përfshirë koston e personelit të caktuar për Projektin mund të konsiderohen si bashkëfinansim në buxhetin e projektit kur paguhen nga Aplikanti ose partnerët e tij. Për sa u përket kostove operative, bashkëfinansimi duhet të jetë i identifikueshëm dhe i verifikueshëm nga dokumentet mbështetëse.

Kostot e papranueshme

Kostot e mëposhtme janë të papranueshme:

- borxhet dhe provigjionet për humbjet ose borxhet;
- interesi i papaguar;
- artikujt e financuar në një kuadër tjetër;
- kreditë për palë të treta;
- pagat, pagesa sigurie dhe kosto të tjera të lidhura me shpërblime për punonjësit publikë (përveç kostove të dietave dhe udhëtimit të hasura në lidhje me zbatimin e Projektit).

3.2. Si të aplikohet dhe procedurat që duhen ndjekur

3.2.1. Formulari i Aplikimit për Grant, Buxheti dhe Plani i Veprimit

Propozimet duhet të paraqiten duke përdorur Formularin e Aplikimit për Grant, Buxhetit dhe Planit të Veprimit të bashkëlidhur me këto Udhëzime (përkatësisht Shtojca A, D dhe E). Aplikantët duhet të ruajnë rigorozisht formatin e aplikimit dhe të plotësojnë paragrafët duke dhënë të gjithë informacionin e kërkuar.

Në Formularin e Aplikimit për Grant, aplikanti duhet të jetë i përpiktë dhe të paraqesë detaje të mjaftueshme, veçanërisht se si do të arrihen objektivat e Projektit, përfitimet që do të vijnë prej tij dhe mënyra se si ai lidhet me objektivat e IADSA II sipas kësaj Thirrje për Propozime. Ai duhet të plotësohet me kujdes dhe sa më qartë që të jetë e mundur në mënyrë që të mund të vlerësohet siç duhet.

Buxheti duhet të plotësohet siç duhet duke përdorur formatin e dhënë. Kostot nuk mund të jenë vlerësime në shumë të përgjithshme, por të detajuara, dhe njësitë e sasi të kostove duhet të jenë të specifikuar që secilin zë buxhetor, për të lejuar vlerësimin e efikasitetit të kostos së Propozimit. Plani i Veprimit duhet të jetë realist dhe duhet të marrë në konsideratë kohën e nevojshme për kryerjen e procedurave të zbatimit, siç përshkruhet në Shtojcën L (p.sh. përzgjedhja e stafit, prokurimi, etj), si dhe kërkesat e raportimit.

Çdo gabim që ka të bëjë me pikat e renditura në Listën e Kontrollit (seksioni IV i Formularit të Aplikimit për Grant), mosdhënia e informacionit të kërkuar, ose çdo mungesë kryesore pajtueshmërie në Propozim (për shembull sasi të dhe/ose aktivitetet e përmendura në buxhet janë të papajtueshme me ato të përmendura në Formularin e Aplikimit për Grant) mund të çojnë në refuzimin e Propozimit.

Sqarimet do të kërkohen vetëm nga NjMT-ja e Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s kur informacionet e dhëna janë të paqarta.

3.2.2. Si dhe ku do të dërgohen propozimet

Propozimet e plota (Formulari i Aplikimit për Grant në **SHTOJCËN A**, Formulari për Entitetet Ligjore në **SHTOJCËN B**, Deklaratat e Partneritetit në **SHTOJCËN C** (nëse ka), Formulari i Buxhetit në **SHTOJCËN D**, Plani i Veprimit në **SHTOJCËN E**, Marrëveshja e Partneritetit në **SHTOJCËN F** (nëse ka). Dokumentet mbështetëse për Aplikantët të renditura në **SHTOJCËN G**, Dokumentet Mbështetëse për Partnerët në **SHTOJCËN H** (nëse ka të tillë), duhen dorëzuar në një origjinal dhe 2 kopje. Formulari i plotë i aplikimit për grant, buxheti dhe plani i veprimit duhet të dërgohen edhe në format elektronik (CD-Rom ose USB). Formatin elektronik duhet të përmbajë **saktësisht të njëjtin** Propozim si dhe versionin në letër të bashkëlidhur. Çdo komponent i Propozimit (Formulari i Aplikimit për Grant, Buxheti dhe Plani i Veprimit) duhet të paraqiten në një dosje elektronike të veçantë dhe unike (për shembull formulari i aplikimit për grant duhet të mos ndahet në disa dosje të ndryshme).

Mosdorëzimi qoftë edhe i një prej dokumenteve të kërkuara në formatin e përcaktuar përbën refuzim të menjëhershëm të Propozimit.

Formulari i Entiteteve Ligjore në **SHTOJCËN B**, Deklaratat e Partneritetit në **SHTOJCËN C** (nëse ka) dhe Marrëveshja e Partneritetit në **SHTOJCËN F** (nëse ka) **duhet të firmosen dhe vulosen (me vulë të njomë) në original**. Mungesa e firmave apo vulave origjinale me bojë të njomë do të çojë në refuzimin e menjëhershëm të Propozimit.

Aplikantët duhet të aplikojnë në **anglisht**. Propozimet e shkruara me dorë **nuk** do të pranohen.

Për të lehtësuar përpunimin e Propozimeve, ju lutemi të paraqisni dosjen origjinale dhe dy kopje në formatin A4, çdonjëri i lidhur (ju lutemi mos përdorni kapakë plastikë). Pas caktimit të projekteve të suksesshme, kopjet e Projekt Propozimeve të cilat nuk janë miratuar për financim do të mbeten në NjMT për një periudhë maksimale prej tre muajsh, pas së cilës do të shkatërrohen nëse nuk janë tërhequr nga Aplikanti.

Propozimet e plota duhet të merren në një zarf të vulosur me anë të postës së regjistruar, shërbim korrier privat, ose dorëzim në dorë (dorëzuesit do t'i jepet një vërtetim me datën e marrjes) në adresën e mëposhtme:

Adresa Postare (përfshi dorëzimin në dorë dhe shërbimin korrier privat):

IADSA Programme

Në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, kati 4, Bulevardi Dëshmorët e Kombit

Tiranë – Shqipëri

Për dijeni të Njësisë së Mbështetjes Teknike

Propozimet e dërguara me mjete të tjera (për shembull me faks ose me e-mail) ose të dorëzuara në adresa të tjera, nuk do të pranohen.

Mbi Zarf duhet të shënohet **numri i referencës së thirrjes për Propozime dhe emri i Bashkisë Aplikante** dhe fjalët “Të mos hapet para seancës së çeljes”. Zarfë do të përmbajë Formularin e Aplikimit për Grant (Shtojca A), Formularin e Entiteteve Ligjore (Shtojca B), Deklaratat e Partneritetit (Shtojca C) nëse ka, Formularin e Buxhetit (Shtojca D), Planin e Veprimit (Shtojca E) Marrëveshjen e Partneritetit nëse ka (Shtojca F), Dokumentet mbështetëse për Aplikantin (Shtojca G) dhe Dokumentet Mbështetëse për Partnerët, nëse ka (Shtojca H).

Aplikantët duhet të verifikojnë nëse propozimi i tyre është i plotë. Propozimet e paplota nuk do të pranohen.

3.2.3. Afati për pranimin e Propozimeve

Afati për pranimin e Propozimeve të plota është **31 Janar, 2020 në 12:00** sipas orës lokale (mesditë). Çdo Propozim i marrë pas afatit nuk do të pranohet automatikisht edhe në qoftë se vula postare tregon një datë që paraprin afatin ose në qoftë se vonesa është për shkak të shërbimit të korrierit privat.

3.2.4. Informacion i mëtejshëm

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail ose me faks jo më vonë se 14 ditë para afatit për pranimin e propozimeve në adresat e renditura më poshtë, duke treguar qartë referencën e Thirrjes për Propozime:

Adresa në e-mail: tsu@iadsa.info

Përgjigjet do të jepen vetëm me shkrim jo më vonë se 10 ditë para afatit për pranimin e Propozimeve.

Në interes të trajtimit të barabartë të Aplikantëve, NjMT-ja e Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s nuk mund të japë opinion paraprak për pranueshmërinë e një aplikanti, partneri apo projekti.

Pyetjet që mund të lidhen me Aplikantë të tjerë, së bashku me përgjigjet, do të publikohen në internet në faqen e internetit të IADSA-s (<http://www.iadsa.info/index.php>) në faqen FAQ, në Shqip, Italisht dhe Anglisht.

3.3. Vlerësimi dhe përzgjedhja e Propozimeve

Të gjithë Propozimet e paraqitura do të vlerësohen në përputhje me hapat dhe kriteret e mëposhtme.

3.3.1. HAPI 1: Kontrolli administrativ

Hapja dhe kontrolli administrativ do të ndërmerren menjëherë pas afatit të fundit (shihni paragrafin 3.2.3). Në seancën e hapjes të gjitha Propozimet e dorëzuara brenda afatit do të regjistrohen dhe vetëm zarfet mbi të cilët është shkruar qartë emri i Bashkisë Aplikante (shihni paragrafin 3.2.2) do të hapen. Nëse nuk është respektuar afati dhe/ose pjesa e jashtme e zarfit nuk paraqet emrin e Bashkisë Aplikante, Propozimi do të refuzohet (shihni paragrafin 3.2.3).

Sa më poshtë do të vlerësohen gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ:

- Nëse ndonjë nga dokumentet dhe/ose informacionet e kërkuara në Shtojcat A, B, C, D, E

dhe F mungon ose nuk është i saktë, Propozimi do të refuzohet **vetëm** mbi këtë bazë dhe Propozimi nuk do të vlerësohet më tej.

- Çdo dokument mbështetës, që mungon ose që nuk është i plotë dhe që është dorëzuar nga Aplikanti dhe partneri(ët) e tij, nëse ka (përkatësisht të renditur në Shtojcën G dhe në Shtojcën H), mund të rezultojë në refuzimin automatik të Propozimit vetëm mbi këto baza.
- Mungesa e firmave të përfaqësuesve ligjorë dhe vulave origjinale me bojë të njomë në Formularin e Entiteteve Ligjore në SHTOJCËN B dhe Deklaratat e Partnerëve në SHTOJCËN C (nëse nevojitet) dhe në Marrëveshjen e Partneritetit në SHTOJCËN F (nëse nevojitet) do të shkaktojë refuzimin e menjëhershëm të Propozimit vetëm mbi këtë bazë.

3.3.2. HAPI 2: Verifikimi i pranueshmërisë

Verifikimi i pranueshmërisë (shih paragrafin 3.1.) do të kryhet si vijon:

- Formulari i Aplikimit për Grant, Buxheti dhe Plani i Veprimit do të kontrollohen në mënyrë të ndërthurur për të verifikuar përputhshmërinë e plotë të Propozimit me kriteret e pranueshmërisë.
- Deklarata nga aplikanti dhe partner/ët (Seksionet II dhe III të Formularit të Aplikimit për Grant) do të verifikohen me dokumentet mbështetëse të dhëna nga aplikanti dhe partneri/ët e tij në qoftë se ka (të renditura përkatësisht në Shtojcën G dhe Shtojcën H). Çdo dokument mbështetës i munguar ose çdo inkoherencë midis Deklaratës nga Aplikanti dhe dokumenteve mbështetës mund të çojë automatikisht në mospranimin e Propozimit mbi këtë bazë të vetme.
- Pranueshmëria e Aplikantit, partnerëve, projektit, kornizës kohore dhe kostove do të verifikohet sipas kriterëve të paraqitura në seksionet 3.1.1., 3.1.2., 3.1.3 dhe 3.1.4. Nëse Propozimi nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë, Propozimi nuk do të vlerësohet më tej.

Aplikantëve mund t’iu kërkohen sqarime në rastin e mos përputhjeve të vogla në Propozimet e dorëzuara në lidhje me përputhshmërinë administrative të lartpërmendur dhe kriteret e pranueshmërisë. Aplikantëve do t’u jepen 7 ditë kalendarike pas njoftimit për të dhënë sqarimin. Kërkesat për sqarim do të bëhen vetëm përmes email-it në adresën e email-it të personit të kontaktit të caktuar në Formularin e Aplikimit për Grant (Seksioni II “Aplikanti”). Mos dhënia e këtyre sqarimeve brenda afatit të caktuar rezulton në refuzimin e Propozimit vetëm mbi këtë bazë.

3.3.3. HAPI 3: Vlerësimi i Propozimit

Një vlerësim i cilësisë së Projekt Propozimeve, që kanë kaluar me sukses kontrollin administrativ dhe verifikimin e pranueshmërisë, do të realizohet sipas kriterëve të paraqitura në Tabelën Vlerësuese të përfshirë më poshtë. Ka dy lloje të kriterëve të vlerësimit: kriteret e

përzgjedhjes (të renditura në seksionin 1 të Tabelës Vlerësuese) dhe kriteret shpërblyese (të renditura në seksionet 2, 3, 4, dhe 5 të Tabelës Vlerësuese).

Kriteret e përzgjedhjes janë menduar të vlerësojnë kapacitetin menaxherial dhe operacional të Aplikantëve dhe të partnerëve të tyre, nëse ka të tillë, për t'u siguruar që ata:

- kanë mandatin statutor, kapacitetin menaxherial, kompetencat profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për të përfunduar me sukses projektin e propozuar brenda kuadrit kohor të specifikuar. Kjo zbatohet edhe për çdo partner të aplikantit.

Kriteret e vendimit bëjnë të mundur përzgjedhjen e Propozimeve kundrejt objektivave dhe strategjisë së Thirrjes për Propozime. Ato po ashtu mbulojnë aspekte të tilla si cilësia, ndikimi i pritshëm, realizueshmëria brenda kuadrit kohor të propozuar, qëndrueshmëria dhe efikasiteti i kostos. Këto kritere mund ta lejojnë Komitetin e Menaxhimit të IADSA-s të vendosë për grant për projektet që maksimizojnë efikasitetin e përgjithshëm të kësaj Thirrje për Propozime.

Vlerësimi me pikë: - Tabela vlerësuese është ndarë në seksione dhe nëseksione. Çdo nëseksioni do t'i jepet një pikaverazh midis 1 dhe 5, si vijon: 1=shumë dobët; 2= dobët; 3=mestar; 4= mirë; 5= shumë mirë. Nëseksioneve me ndikim të rëndësishëm do t'u jepet pikaverazh i dyfishtë.

Tabela Vlerësuese

Seksioni 1. Përputhshmëria dhe efikasitetit i partneritetit	Pikët
1.1 A është projekti në përputhje me kapacitetet menaxheriale dhe teknike të aplikantit dhe partnerëve?	5
1.2 A është partneriteti i propozuar (nëse ka) i lidhur vetëm me arritjet e dëshiruara?	5
Vlerësimi total me pikë:	10

Ju lutemi vini re se në qoftë se vlerësimi total i arritur për Seksionin 1 është më i ulët se 7 pikë, i tërë aplikimi do të eliminohet nga Komiteti Vlerësues.

Seksioni 2. Përshtatshmëria e projektit	Pikët
2.1 Sa ka lidhje propozimi me objektivat e prioritetet e specifikuar në këtë Thirrje për Propozime (lidhja me strategjitë kombëtare për zhvillim e integrim të Qeverisë së Shqipërisë, strategjitë sektoriale dhe ndër- sektoriale të përditësuara dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit si dhe Programin Italo-Shqiptar të Asistencës për Zhvillim)?	5
2.2 Sa ka lidhje propozimi me nevojat dhe kufizimet e veçanta të zonave të planifikuara? (përfshirë përputhshmërinë me përparësitë sociale kombëtare, sinergjinë me iniciativat e tjera të Bashkëpunimit Italian të Zhvillimit dhe shmangien e dublimit)	5x2
2.3 Ata sa qartësisht janë të përcaktuar dhe sa qartësisht janë të përzgjedhur personat e përfshirë (përfituesit fundorë, grupet e synuara)? A janë përcaktuar qartë nevojat e tyre dhe a i adreson siç duhet ato propozimi?	5
2.4 A përmban propozimi elementë specifikë të vlerës së shtuar, si inovacioni dhe praktikat më të mira dhe/ose bashkëfinancim nga aplikanti ose partnerët (nëse ka), dhe/ose masa efektive për trajtimin e barazisë gjinore, zhvillimin e balancuar rajonal dhe/ose krijimin e partneriteteve të reja midis entiteteve publike vendore, si partneritetet rajonale dhe/ose përputhshmëri me projekte/programme të tjera, dhe/ose fushëveprim për përsëritje duke krijuar kështu efekte të shumëfishta?	5x2
Vlerësimi total me pikë:	30

Seksioni 3. Efikasiteti dhe realizueshmëria e projektit	Pikët
3.1 A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme (sa koherent është hartimi i përgjithshëm i projektit)?	5
3.2 A është i qartë, i hartuar mirë, i qëndrueshëm dhe i realizueshëm plani i veprimit?	5
3.3 A përmban propozimi tregues objektivisht të verifikueshëm për rezultatet e projektit?	5
3.4 A është i kënaqshëm niveli i përfshirjes dhe pjesëmarrjes së përfituesve të synuar?	5
Vlerësimi total me pikë:	20

Seksioni 4. Qëndrueshmëria e Projektit	Pikët
4.1 A ka të ngjarë që projekti të ketë një ndikim të prekshëm tek grupet e tij të synuara?	5x2
4.3 A janë të qëndrueshme rezultatet e pritshme të projektit të propozuar: <ul style="list-style-type: none"> - financiarisht (<i>si do të financohen aktivitetet pasi të përfundojë financimi?</i>) - institucionalisht (<i>a do të vazhdojnë të jenë në vend strukturat që lejojnë aktivitetet në përfundim të projektit? A do të ketë “pronësi” vendore të rezultateve të projektit?</i>) - në nivel politikash (atje ku është e zbatueshme) (<i>cili do të jetë ndikimi strukturor i projektit, për shembull a do të çojë ai në përmirësim të legjislacionit, kodeve të sjelljes, metodave, etj.</i>)? - ekologjikisht (atje ku është e zbatueshme) (<i>a do të ketë veprimi një ndikim negativ/pozitiv mjedisor?</i>) - nga pikëpamja sociale (<i>a do të ketë projekti një ndikim social pozitiv mbi gratë, fëmijët dhe të rinjtë, grupet e dizavantazuara dhe minoritetet?</i>) 	5 x 2
Vlerësimi total me pikë:	20

Seksioni 5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos së projektit	Pikë
5.1 A janë pasqyruar siç duhet aktivitetet në buxhet?	5x2
5.2 A është i kënaqshëm raporti midis kostove të menduara dhe rezultateve të pritshme?	5x2
Vlerësimi total me pikë:	20

Seksioni 6. Pikaverazhi në total	Pikë
6.1 Partneriteti	10
6.2 Përshtatshmëria e projektit	30
6.3 Efikasiteti dhe realizueshmëria e projektit	20
6.4 Qëndrueshmëria e projektit	20
6.5 Buxheti dhe efikasiteti i kostos së projektit	20
Vlerësimi total maksimal:	100

Përzgjedhja provizore – Pas vlerësimit, Njësia Mbështetëse Teknike do të krijojë një tabelë që liston Propozimet e renditura sipas pikaverazhit të tyre në total dhe shumës totale të disponueshme, e cila do t'i dorëzohet Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s.

3.4 Njoftimi i vendimit të Komitetit të Menaxhimit të IADSA

3.4.1. Përmbajtja e vendimit

Pas përfundimit të plotë të vlerësimit (HAPI 3), me miratim nga Komiteti i Menaxhimit i IADSA-s, Aplikantët e Projekt Propozimeve të përzgjedhura do të njoftohen me shkrim nga NjMT-ja mbi vendimin e Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s lidhur me propozimin e tyre.

Vetëm Propozimet që kanë marrë një vlerësim prej të paktën 60 pikësh nga 100 të mundshme do të merren në konsideratë nga Komiteti i Menaxhimit i IADSA-s për akordim granti.

Vendimi i Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s për të mos pranuar një propozim ose për të mos akorduar një grant është përfundimtar.

Rezultatet e vlerësimit dhe përzgjedhja e Projekt Propozimeve do të bëhet publike në faqen e internetit të IADSA-s (<http://www.iadsa.info>) pas miratimit nga Komiteti i Menaxhimit i IADSA-s.

4. LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA A: FORMULARI I APLIKIMIT PËR GRANT (WORD)

SHTOJCA B: FORMULARI I ENTITETEVE LIGJORE (FORMATI WORD)

SHTOJCA C: DEKLARATA E PARTNERITETI

SHTOJCA D: BUXHETI (FORMATI EXCEL)

SHTOJCA E: PLANI I VEPRIMIT (FORMATI EXCEL)

SHTOJCA F: MARRËVESHJA E PARTNERITETIT

SHTOJCA G: DOKUMENTET MBËSHTETËSE PËR APLIKANTIN

SHTOJCA H: DOKUMENTET MBËSHTETËSE PËR PARTNERËT

SHTOJCA I: KONTRATA E PROJEKTIMIT DHE FINANCIMIT

SHTOJCA L: UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT